



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Nr. i Dokumentit: 22.5.1-2016-08

**RAPORTI I AUDITIMIT
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË KOMUNËS SË KLINËS
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016**

Prishtinë, qershor 2017

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Klinës, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Edon Kabashi (udhëheqës i ekipit), Pleurat Isufi dhe Mehmet Kurti, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të auditimit Astrit Bllaca.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	6
2 Qeverisja.....	9
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	15
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	24
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	25
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	28
Shtojca IV: Letërkonfirmimi	35

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetore të Komunës së Klinës për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit¹, të datës 25.11.2016.

Auditimi ynë është fokusuar në:



(Më gjerësisht, shih Shtojcën 1)

Niveli i punës së kryer nga Zyra Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i komunës.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Theksimi i çështjes

Si theksim i çështjes dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se regjistri i e-pasurisë nuk është i saktë për arsye se blerjet nga Shëndetësia dhe Arsimi nuk janë përfshirë në këtë regjistër.

Për më gjerësisht shih Pjesën 1.1 të këtij Raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

¹ Termi “Plani i Jashtëm i Auditimit” është zëvendësim i termit “Memorandumi i Planifikimi të Auditimit”

Dëshirojmë të falënderojmë Kryetarin e Komunës dhe stafin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore

Procesi i përgatitjes së draft PFV-ve është menaxhuar dobët, dhe për shkak të mungesës së rishikimeve menaxhariale, ka rezultuar me disa gabime financiare. Gabimet në versionin fillestar të pasqyrave janë korrigjuar pas sugjerimeve tona.



Kryetari duhet të sigurohet se procesi i përgatitjes së PFV 2017 përfshinë një rishikim menaxherial formal dhe efektiv dhe deklarata për PFV-të të nënshkruhet vetëm pasi janë zbatuar të gjitha veprimet e nevojshme (shih nën kapitullin 1.1).

Procesi i vetvlerësimit dhe përgjigja ndaj rekomandimeve të vitit paraprak nuk po adresohen ashtu siç kërkohet për zhvillimin dhe përmirësimin e organizatës.



Kryetari duhet ta zbatojë një proces rigoroz për të siguruar që procesi i vetvlerësimit dhe rekomandimet e vitit paraprak adresohen në mënyrë aktive ku çështjet/progreset kyçe i raportohen menaxhmentit në baza mujore (shih çështjet 2 dhe 3).

Aranzhimet e qeverisjes që kanë të bëjnë me përcaktimin e planeve strategjike, raportimin menaxherial dhe llogaridhënien janë të dobëta. Aktiviteti i Auditimit të Brendshëm nuk i mbështetë zhvillimet në këtë fushë.



Kryetari duhet të sigurojë që aranzhimet e Qeverisjes janë rishikuar në mënyrë kritike për t'u siguruar se janë bërë ndryshime adekuate në përmirësimin e aranzhimeve të llogaridhënies dhe raportimit menaxherial për ta ngritur efektivitetin operativ të mbështetur nga një NJAB (shih çështjet 4,5 dhe 6).

Edhe pse në disa fusha kontrollet e brendshme janë efektive - ekzistojnë ende dobësi në disa sisteme të rëndësishme financiare duke përfshirë prokurimin.



Kryetari duhet ta aplikojë një vlerësim të detajuar të prokurimit dhe fushave tjera brengosëse të theksuara në këtë Raport për t'i identifikuar arsyet për paraqitjen e dobësive si dhe veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato (shih çështjet 7 deri 17).

Përgjigja e Kryetarit të Komunës

Kryetari i Komunës ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna. Më tutje Kryetari i Komunës është zotuar që:

- të shqyrtoj Raportin e auditimit në Asamblenë Komunale; dhe
- deri në fund të muajit janar 2018, ta diskutoj në Asamblenë Komunale progresin lidhur me zbatimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PFV 2017 të jenë dorëzuar në Ministrinë e Financave

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Komunës së Klinës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi ynë është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se regjistri i pasurisë nën 1,000€, nuk prezanton gjendjen reale të pasurisë në PFV, për arsye se në regjistrin e-pasuria nuk janë përfshirë blerjet nga Arsimi dhe Shëndetësia.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Klinës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Nga komuna kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMPPP-së nr. 03/L-048, (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Dorëzimin e raporteve të rregullta tremujore në Kuvend Komunal; dhe
- Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit me kohë.

Çështjet e ngritura në Memorandumin e Auditimit, të datës 23.12.2016, në lidhje me kornizën raportuese ishin adresuar nga menaxhmenti.

Draft PFV-të e vitit 2016 përmbanin gabime, për të cilat ne kemi dhënë sugjerime për t'i korrigjuar. Menaxhmenti ka marrë parasysh sugjerimet tona dhe i ka përmirësuar PFV finale. Në kontekst të PFV-ve, nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me kornizën raportuese.

DEKLARATA E BËRË NGA MENAXHMENTI I KOMUNËS

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Financiar, me rastin e dorëzimit të draft PFV-ve në Ministrinë e Financave, mund të konsiderohet e saktë, përveç mos regjistrimit të pasurisë të theksuar tek opinionin e auditimit, por që nuk ka ndikim material.

1.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit

Për çështjet e sipër përmendura jepet rekomandimi:

Rekomandimi 1 Kryetari duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe pragmatike për të siguruar regjistrim të saktë të pasurive. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

2 Qeverisja

Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për komunën që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi përmes këtyre pasqyrohen përmirësimet e proceseve ekzistuese dhe kontrolleve. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një OB të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse. Prandaj, kemi aplikuar një qasje konsistente në të gjitha auditimet për të përcaktuar cilësinë e listave kontrolluese të plotësuara për vet-vlerësim dhe për ta vlerësuar saktësinë e gjendjes së paraqitur mbi qeverisjen në Kosovë.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- Fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- Fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive në procesin qeverisës të komunës, veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial. Lista kontrolluese e vet-vlerësimit, e plotësuar nga komuna, e pasqyron këtë situatë vetëm pjesërisht, me disa komente pozitive mbi ekzistimin e aranzhimeve ekzistuese, por që nuk bazohen në dëshmi.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit. Niveli i implementimit të rekomandimeve të vitit të kaluar nuk ishte në nivel të kënaqshëm, për shkak se nga 22 rekomandimet e dhëna, vetëm 6 ishin zbatuar plotësisht.

Komuna e Klinës ka një strategji të zhvillimit ekonomik për vitin 2017 – 2021 e cila ishte në proces të finalizimit dhe dërgimit për aprovim në kuvendin komunal, por për vitin 2016 nuk kishte një plan të tillë si dhe mbetet sfidë për hartimin e planeve tjera strategjike;

Auditimi i Brendshëm kishte ofruar një pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë së kontrolleve të brendshme dhe kishte dhënë rekomandime për përmirësimin e tyre.

Në vitin 2016, komuna ka përdorur rreth 94% të buxhet final me një zvogëlim për rreth 4% në krahasim më vitin paraprak. Kjo tregon një trend në rënie në shpenzimin e buxhetit krahasuar me vitin paraprak.

2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2015, ka rezultuar me 22 rekomandime. Komuna kishte përgatitur planin e veprimit ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen këto rekomandime. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, gjashtë (6) rekomandime janë zbatuar, katërmëdhjetë (14) ishin në proces të zbatimit dhe dy (2) rekomandime nuk ishin zbatuar.

Raporti i auditimit për PFV 2015, ishte diskutuar në Kuvendin Komunal.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

Çështja 2 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

- | | |
|----------------------|--|
| E gjetura | Komuna, përgjithësisht i ka trajtuar rekomandimet e auditimit, disa prej të cilave i ka zbatuar në tërësi dhe pjesa më e madhe janë në proces e sipër. Por, përkundër një përkushtimi të shtuar në zbatimin e rekomandimeve të vitit të kaluar, ende nevojiten përmirësime. Komuna nuk ka ndjekur një proces të vazhdueshëm për të menaxhuar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm. Dy nga rekomandimet të cilat nuk janë zbatuar lidhen me mungesë të regjistrit të rreziqeve dhe mungesën e monitorimit formal e zbatimit të rekomandimeve. |
| Rreziku | Përderisa rekomandimet e dhëna nuk adresohen, dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve tjera në sistemet financiare kyçe, vazhdojnë të jenë të pranishme dhe rreziqet operative të mos korrigjohen. |
| Rekomandimi 2 | Kryetari duhet të siguroj se do të zbatohet një proces i forcuar i llogaridhënies së stafit përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve, sipas afateve kohore dhe prioriteteve të përcaktuara me planin e veprimit. Monitorimi i progresit të rekomandimeve duhet të bëhet në mënyrë sistematike, dhe aty ku ka ngecje, të propozohen masat adekuate. |

2.2 Pyetëtori i vet-vlerësimit të komponentave të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vet-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vet-vlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar nga një pyetje kyçe në secilën komponentë të listës kontrolluese. Ne kemi përmbledhur më poshtë të gjeturat tona të auditimit. Kjo nuk ka për qëllim të ofroj komente për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vet-vlerësimit, por do të pasqyrojë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për të mbështetur përpjekjet e Ministrisë së Financave në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 3 - Pyetëtori i vet-vlerësimit - Prioritet i lartë

E gjetura Si pjesë e auditimit tonë, kemi shqyrtuar çështjet kyçe të pyetësorit të vetvlerësimit në lidhje me pesë komponenta. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se:

1. Pyetëtori i vet-vlerësimit i plotësuar nga komuna ka vërtetuar se sistemet e kërkuara të menaxhimit të rrezikut nuk ishin ende funksionale. Kjo, për shkak se komuna ende nuk e kishte hartuar një listë e rreziqeve.
2. Komuna ishte në përgatitje të një strategjie të zhvillimit ekonomik pesë (5) vjeçare për periudhën 2017-2021, por që ende nuk ishte finalizuar. Çështjet e planeve strategjike janë shqyrtuar më hollësisht në nënkapitullin 2.3.1;
3. Lidhjet në mes të planit të prokurimit dhe buxhetit si dhe përpilimi i raporteve adekuate në baza të rregullta kohore konsiderohen si të vendosura nga Komuna e Klinës dhe dëshmitë që na janë dhënë, e mbështesin këtë konkluzion, edhe pse raportet nuk janë përpiluar gjithmonë në baza të rregullta kohore.
4. Auditimi i Brendshëm nuk i ka theksuar çështjet më lartë. Për më shumë, veprimet e ndërmarra për adresimin e çështjeve të identifikuar nga vetvlerësimi i vitit 2016 janë të limituara. Kjo, për shkak të mungesës së qartësisë brenda komunës që ka të bëjë me rëndësinë e kësaj liste kontrolluese dhe me atë se kush është zyrtari përgjegjës që i përdorë këto mekanizma për t'i mbështetur përmirësimet operative.

Rreziku Aranzhimet e dobëta të qeverisjes ndikojnë në dobësimin e proceseve strategjike dhe operative dhe e zvogëlojnë mundësinë e reagimit me kohë dhe marrjen e masave të duhura për reduktimin e rreziqeve në nivel të pranueshëm.

Rekomandimi 3 Kryetari të siguroj se është rishikuar sistemi i qeverisjes, në veçanti në fushën e menaxhimit të rreziqeve dhe aprovimin e strategjisë së zhvillimit ekonomik, si dhe një proces i monitorimit sistematik të aktiviteteve në këto dy fusha, duhet të vendoset brenda një periudhe të arsyeshme.

2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit Komuna e Klinës operon dhe sfidat me të cilat përballet.

2.3.1 Përcaktimi i objektivave strategjike

Të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara të përgatisin dhe të përcjellin planet strategjike në nivel të organizatës. Komuna posedon dokumentin që përfshinë edhe përudhen e vitit 2016 “Plani strategjik rregullues i hollësishëm për periudhën kohore 5 vjeçare nga viti 2016-2020”.

Çështja 4 – Mungesa e planeve strategjike të zhvillimit dhe planeve tjera - Prioritet i lartë

E gjetura	<p>“Strategjia e zhvillimit rajonal” gjendet si dokument në komunë, por që i takon një periudhe të kaluar, pra për vitet 2010-2013;</p> <p>Strategjia e zhvillimit ekonomik e Komunës së Klinës për vitin 2017 – 2021 ishte në proces të finalizimit dhe dërgimit për aprovim në kuvendin komunal;</p> <p>Plani strategjik kundër korrupsionit nuk është përgatitur, por është përfshirë vetëm si pjesë përbërëse e planit të hartuar për integritet për vitin 2017-2019; dhe</p> <p>Plani i reagimit emergjent për komunën ishte miratuar në vitin 2014, por që më vonë nuk ishte azhurnuar.</p>
Rreziku	<p>Mungesa e planeve strategjike vështirëson prioritizimin e çështjeve kyçe për zhvillimin dhe mirëqenien e qytetarëve të saj. Mos caktimi i përgjegjësive për koordinim dhe zhvillim të planit strategjik, pamundëson përcjelljen dhe vlerësimin e përmbushjes së objektivave në pikëpamje të vizionit të komunës si një ndër kushtet esenciale të qeverisjes së mirë.</p>
Rekomandimi 4	<p>Kryetari të hartoj dhe propozoj për miratim në Asamblenë Komunale planet strategjike për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të komunës, duke vendosur objektiva të qarta strategjike dhe duke mbikëqyrur dhe matur realizimin e tyre.</p>

2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti zbaton një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja 5 – Dobësi në kontrollet menaxheriale – Prioriteti i lartë

- E gjetura** Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të komunës ka nxjerrë në pah një raportim të dobët financiar mbi shpenzimet dhe të hyrat tek menaxhmenti i lartë si dhe analiza të pakompletuara të ofrimit të shërbimeve. Procesi i raportimit të brendshëm ka rezultuar me një numër dobësish, të cilat kufizojnë një menaxhim më efektiv. Përgjegjësitë janë të kufizuara dhe nuk janë duke u zbatuar në mënyrë të duhur.
- Rreziku** Cilësia e dobët e raportimit financiar dhe e aktiviteteve tek menaxhmenti i lartë, redukton aftësinë e menaxhmentit për të menaxhuar aktivitetet e komunës në mënyrë pro aktive si dhe ulë efektin e kontrolleve buxhetore. Kjo mund të rezultojë në deficit ose suficit të paplanifikuar dhe të vonojë veprimet e nevojshme për t'i adresuar ato. Kjo gjithashtu mund të bëjë që të hyrat të mos arkëtohen siç pritet. Ngjashëm, mund të rezultojë edhe në ofrimin e shërbimeve jo cilësore.
- Rekomandimi 5** Kryetari të siguroj se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë. Një zgjidhje e përshtatshme duhet të vendoset deri në fund të këtij viti.

2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me dy anëtarë të stafit – Udhëheqësi i njësisë dhe një auditor. Për vitin 2016, NJAB kishte planifikuar gjashtë (6) auditime dhe kishte përmbushë në tërësi planin e saj vjetor. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe nga mbështetja e ofruar nga një Komitet i Auditimit efektiv.

Çështja 6 – Sfida në auditimin e brendshëm – Prioriteti i lartë

E gjetura	<p>Ekzistojnë dobësi në lidhje me operacionet aktuale të auditimit të brendshëm, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Menaxhmenti nuk kishte përgatitur plane për zbatimin e rekomandimeve të NjAB; dhe • Komiteti i auditimit të brendshëm nuk ishte funksional gjatë gjithë vitit 2016 për arsye se komuna këtë organ e kishte themeluar në fund të shtatorit të vitit 2016.
Rreziku	<p>Mungesa e planit për zbatimin e rekomandimeve të NjAB rritë rrezikun që kontrollet e brendshme të operojnë dobët, të jenë jo efektive dhe mangësitë në këto kontrolle mos të identifikohen me kohë. Mungesa e Komitetit të Auditimit ndikon në mbikëqyrjen, fuqizimin dhe cilësinë e shërbimeve të auditimit të brendshëm.</p>
Rekomandimi 6	<p>Kryetari duhet të siguroj se janë përgatitur planet e veprimit për zbatim të rekomandimeve të nxjerra nga auditimi i brendshëm dhe komiteti i auditimit duhet t'i rishikojë në mënyrë kritike burimet, planet dhe rezultatet e Njësisë së Auditimit të Brendshëm dhe të kontribuojë në përmirësimin e përgjithshëm të menaxhimit të komunës.</p>

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Prokurimi edhe më tej vazhdon të mbetet shqetësim kryesor për komunën, për shkak se nuk janë zbatuar sa duhet rregulloret, dhe kjo ka rezultuar në vlerë të dobët për paranë e shpenzuar si dhe vonesa në përfundimin e projekteve dhe realizimin e pagesave. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat në përgjithësi nuk kanë qenë të mjaftueshme dhe nuk janë duke u zbatuar në mënyrë efektive, ndërsa kontrollet mbi kategoritë tjera të e shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar parregullsitë dhe të shtohet vlera për para.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar të hyrat e arkëtuara, burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Pranimet	2015 Pranimet	2014 Pranimet
Të hyrat vetjake	1,028,000	1,028,000	841,112	790,640	916,415

Të hyrat e planifikuara në vitin 2016 ishin realizuar 82% të buxhetit final. Te pranimet janë përfshirë edhe të hyrat nga gjobat e trafikut dhe dënimet e gjykatave, në vlerë 142,177€², të cilat janë mbledhur nga institucionet qendrore. Arkëtimi i të hyrave për vitin 2016 reflekton rritje në vlerë 50,472€ apo rreth 6% më tepër, krahasuar me vitin paraprak.

² Gjobat/dënimet e Policisë së Kosovës nga trafiku 107,970€ dhe Gjobat/dënimet nga Gjykata 34,207€.

Tabela 2. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ³	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Burimet e Fondeve:	8,333,886	8,794,798	8,271,869	8,611,908	8,244,581
Granti i Qeverisë -Buxheti	7,305,886	7,513,996	7,511,739	7,616,657	7,403,596
Të bartura nga viti paraprak ⁴ -	-	206,498	196,119	351,515	218,812
Të hyrat vetjake ⁵	1,028,000	1,028,000	522,829	599,139	550,029
Donacionet e brendshme	-	36,484	31,362	40,447	42,238
Donacionet e jashtme	-	9,820	9,820	4,150	29,906

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 460,912€. Kjo rritje është rezultat i rritjes së grantit qeveritar për 208,110€, të hyrave të bartura nga viti paraprak 206,498€, donacioneve të brendshme për 36,484€ dhe donacioneve të jashtme për 9,820€.

Në vitin 2016, komuna ka ekzekutuar 8,271,869€ apo 94% të buxhet final, me një zvogëlim për rreth 4% krahasuar me vitin 2015. Megjithatë, realizimi i buxhetit mbetet në nivel jo shumë të kënaqshëm te kategoria e investimeve kapitale dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

Tabela 3. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	8,333,886	8,794,798	8,271,869	8,611,908	8,244,581
Pagat dhe Mëditjet	5,592,191	5,688,776	5,674,868	5,570,740	5,084,286
Mallrat dhe Shërbimet	613,588	629,044	606,417	620,164	632,964
Shërbimet komunale	151,258	161,288	161,095	170,353	133,469
Subvencionet dhe Transferet	65,767	74,124	61,656	79,502	92,155
Investimet Kapitale	1,911,082	2,241,566	1,767,833	2,171,149	2,301,707

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Rritja e buxhetit për paga dhe mëditje për 96,585€ është rezultat i vendimit të qeverisë për 84,487€, të hyrave vetjake të bartura 2,277€ dhe nga grantet e donatorëve 9,820€.
- Rritja e buxhetit për mallra dhe shërbime për 15,456€ është rezultat i zvogëlimit të buxhetit me rishikim për 10,000€, rritja nga të hyrat e bartura për 27,122€ dhe zvogëlimi nga qeveria për 1,666€.

³ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

⁴ Të hyrat vetjake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁵ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e buxhetit të vet.

- Buxheti për subvencione dhe transfere është rritur për 8,357€ si rezultat i të hyrave vetjake të bartura.
- Rritja e buxhetit për investime kapitale për 330,484€ është rezultat i të hyrave vetjake të bartura për 168,712€, vendimit të qeverisë prej 125,288€ dhe nga grantet e donatorëve 36,484€.

Çështja 7 – Realizimi i buxhetit – Prioriteti i lartë

E gjetura	Realizimi i buxhetit përgjithësisht ishte në nivelin e pritur, me përjashtim të investimeve kapitale (79%) për shkak të mosrealizimit të projekteve. Një ndër projektet e përcaktuara ishte “Ndërtimi me gurë i sheshit dhe rrugëve në qytet”. Fondet e bartura në vitin 2017 në shumën prej 187,471€, janë bërë për arsye të kushteve jo të mira atmosferike për realizimin e punimeve.
Rreziku	Mos realizim i duhur i buxhetit për kategorinë e investimeve kapitale, mund të rezultojë me mos realizimin e projekteve të planifikuara dhe prolongimin e tyre për vitet e ardhshme, rrjedhimisht edhe me cilësinë e dobët të shërbimeve për qytetarët.
Rekomandimi 7	Kryetari duhet të siguroj që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar.

3.1.1 Të hyrat

Buxheti final për të hyrat në vitin 2016 ishte 1,028,000€. Prej tyre ishin realizuar 841,112€ apo 82% e buxhetit të planifikuar. Të hyrat janë realizuar kryesisht nga tatimi në pronë, lejet e ndërtimit, të hyrat nga qiraja, taksa administrative dhe të tjera.

Çështja 8 – Planifikimi i të hyrave – Prioriteti i mesëm

E gjetura	Komuna nuk kishte planifikuar të hyrat nga lejet e ndërtimit dhe taksat për regjistrimin e automjeteve. Gjatë auditimit, ne kemi vërejtur se komuna inkason mjete nga këto lloje të të hyrave.
Rreziku	Mos planifikimi i të hyrave dobëson kontrollet në fushën e ndërtimit, procesin e inkasimeve si dhe pamundëson planifikimin e projekteve për t’u financuar nga këto burime.
Rekomandimi 8	Kryetari duhet të sigurohet se gjatë planifikimit të buxhetit vjetor të ketë në konsiderim të gjitha burimet potenciale të buxhetit, duke marrë për bazë edhe trendin të hyrave vetjake në tri vitet e fundit.

Çështja 9 - Inkasimi i të hyrave - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Në të gjitha rastet qytetarët ishin ngarkuar me tarifë mujore nga 25€, për dërgimin e fëmijëve në çerdhe. Kjo vlerë është në kundërshtim me rregulloren për tarifa, e cila përcakton se pagesa duhet të jetë 20€ për muaj. Për vitin 2016, qytetarët kishin paguar në total 13,825€, apo 2,765€ më tepër sesa parashihet me rregulloren e komunës.
- Rreziku** Komuna ka bërë inkasime të tarifave pa ndonjë bazë të qartë ligjore. Mos inkasimi i të hyrave sipas rregullores në fuqi, ndikon që qytetarët të ngarkohen me shuma më të larta nga sa parashihet me rregulloren aktuale dhe kjo mund të dëmtoj kredibilitetin e komunës ndaj qytetarëve. Gjithashtu, ekziston mundësia që qytetarët të kërkojnë rimbursimin e parave të paguara më tepër.
- Rekomandimi 9** Kryetari duhet ta shqyrtoj rastin pse kanë ndodhur mbingarkesat e qytetarëve me këto tarifa si dhe të sigurohet që në mënyrë strikte është duke u aplikuar rregullorja nr. 01/2014 për ngarkesa dhe gjoba komunale. Në të kundërtën, rregullorja duhet të ndryshohet dhe plotësohet sipas tarifave të reja.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti i planifikuar për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 5,688,776€, ndërsa shpenzimet 5,674,868€ apo 99%.

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2016 ishte 629,044 €. Prej tyre ishin shpenzuar 606,417€ apo 96% e buxhetit të planifikuar. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzimet për komunal, udhëtim, telekomunikim, shërbime, blerje e mobileve dhe pajisjeve, derivate dhe lëndë djegëse, shërbime të regjistrimit dhe sigurimit, mirëmbajtje e të tjera.

Çështja 10 – Fituesi i tenderit me çmime jo normalisht të ulëta - Prioritet i lartë

E gjetura Në kontratën e nënshkruar "Furnizimi me artikuj ushqimor të konsumit të përditshëm për çerdhe dhe institucione në varësi të komunës" me vlerë 43,996€, operatori fitues kishte ofertuar me çmime jo normalisht të ulëta për dy artikuj. Artikujt me çmime jo normalisht të ulëta ishin: mielli 25 kg me çmim 0.40€, dhe 1 kg kafe me çmim 1€. Komuna nuk kishte kërkuar nga OE sqarime shtesë në lidhje me çmimet e ofruara.

Rreziku Çmimet jo normalisht të ulëta për artikujt në fjalë, mund të kenë qenë përcaktuese për shpërblimin me kontratë, duke rrezikuar eliminimin nga konkurrenca të OE tjerë me çmime të tregut. Mos kërkesa për sqarime shtesë, ka rrezik që OE mos ta furnizojë komunën me artikujt respektiv.

Rekomandimi 10 Kryetari të siguroj që gjatë procesit të vlerësimit të ofertave, komisioni i vlerësimit merr në konsiderim të gjitha nevojat reale të njërive kërkuese, respektivisht sasi të nevojshme për furnizim, dhe eliminon të gjitha mundësitë e manipulimit me çmime. Përveç kësaj, zyrtari i prokurimit duhet të kujdeset që të furnizohen të gjithë artikujt e kontraktuar sipas sasive të porositura nga njësitë kërkuese, dhe jo vetëm artikujt me çmime të volitshme për operatorin.

Çështja 11 - Mangësi në dokumentimin e çmimeve - Prioritet i mesëm

E gjetura Në kontratën për "Servisim dhe mirëmbajtje të automjeteve zyrtare" çmimi për ndërrimin e pjesëve, ishte paraparë 5-15%⁶ mbi çmimin blerës të artikullit me të cilin është furnizuar OE. Për pagesën në vlerë 1,313€, ne nuk kemi gjetur dëshmitë e çmimeve me të cilat është furnizuar OE.

Rreziku Kryerja e pagesave pa mbështetje në dëshmitë e parapara me kontratë rrit rrezikun që OE të faturoj çmime më të larta sesa tarifën e përcaktuar me kontratë dhe të shkaktohen humbje financiare për komunën.

Rekomandimi 11 Kryetari duhet të sigurojë se asnjë pagesë për shërbimet e mësipërme nuk do të kryhet para se të sigurohen çmimet furnizuese nga OE, dhe më pas, të kalkulohen tarifën e servisimit dhe të mirëmbajtjes.

⁶ Tarifa 5% aplikohet për llojin e automjetit Niva Llada, ndërsa 15% për llojet tjera të automjeteve.

3.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 74,124€. Prej tyre në 2016 ishin shpenzuar 61,656€ apo 83% e buxhetit të planifikuar. Shpenzimet kryesisht kanë të bëjnë me mbështetje të aktiviteteve kulturore, sportive apo ndihma momentale.

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 2,241,566€. Prej tyre në 2016 ishin shpenzuar 1,767,833€. Ato kanë të bëjnë me shpenzime për rregullim të infrastrukturës, ndërtimi objekteve dhe sheshi, asfaltimi i rrugëve, kanalizim, pajisje, përmirësime të ndryshme të kapitalit e të tjera.

Çështja 12 – Vonesa në realizimin e projekteve – Prioritet i lartë

E gjetura Te kontrata “Ndërtimi i kanalizimit në Budisalc” kishte vonesa në realizimin e punimeve nga kontraktuesi, por organi mbikëqyrës apo dhe menaxheri i projektit nuk i kishte raportuar vonesat prej 18 muaj tek zyrtari i prokurimit në mënyrë që të mundësohet aplikimi i penaleve për çdo ditë të vonuar sipas kushteve të kontratës.

Në katër (4) raste kemi vërejtur që situacionet e pranuar nga organi mbikëqyrës ishin pa datë të pranimit, për këtë arsye është e pamundur të dihet se a janë kryer punimet sipas afatit të paraparë në kontratë.

Rreziku Mos raportimi me kohë për kryerjen e punëve dhe mungesa e datës së kryerjes së punës nga organi mbikëqyrës rritë rrezikun që projektet të mos realizohen në pajtim me paramasat e kontraktuara, si dhe vonesat në realizimin e projekteve mund të rezultojnë në dështimin për të përmbushur objektivat e përcaktuara.

Rekomandimi 12 Kryetari të siguroj se organi mbikëqyrës raporton vonesat në realizimin e projekteve dhe menaxheri i projektit nuk pranon raportin nga personat përgjegjës pa datë të pranimit. Në rastet kur vonesat ndodhin pa arsye, penalet zbatohen siç janë kontraktuar si dhe dispozitat e kontratës ekzekutohen në tërësi.

3.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet, subvencione dhe transfere, si dhe investimet Kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet si dhe investimet kapitale:

Çështja 13 - Ekzekutimi i pagesave pa nënshkrime nga personat përgjegjës - Prioritet i mesëm

E gjetura Gjatë testimit të dymbëdhjetë (12) pagesave në vlerë 266,905€ kemi vërejtur se urdhërpagesat ishin nënshkruar nga zyrtarët jo kompetent. Zyrtari certifikues dhe zyrtari shpenzues kishin zëvendësuar njëri-tjetrin gjatë shfrytëzimit të pushimit vjetor pa ndonjë autorizim të veçantë nga Zyrtari kryesor administrativ, por vetëm duke përdorë llogarinë elektronike të njëri-tjetrit, që është në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ të Ministrisë së Financave, nr.02/2009 mbi delegimin e menaxhimit të shpenzimeve të Organizatave Buxhetore.

Rreziku Zëvendësimi i zyrtarit certifikues nga zyrtari shpenzues dhe anasjelltas, rrit rrezikun e aplikimit të kontrolleve të pa mjaftueshme gjatë ekzekutimit të pagesave dhe mund të rezultojë me pagesa të pa rregullta.

Rekomandimi 13 Kryetari të siguroj se nënshkrimi dhe ekzekutimi i urdhërpagesave bëhet vetëm nga personat e autorizuar, dhe zyrtarët kyç të proceseve siç janë zyrtari certifikues dhe ai shpenzues, në rast të mungesës së tyre, të kenë zyrtarët alternativë.

3.2 Pasuritë

3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi i pasurisë është një pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Një menaxhim i mirë i pasurive kërkon që komuna të ketë një pamje të plotë të pasurive, procedura të kontrollit dhe menaxhimit të tyre dhe të azhurnojë vazhdimisht ndryshimet në regjistrat e saj.

Vlera neto e pasurisë së regjistruar në SIMFK në vitin 2016 ishte 81,509,435€, dhe është shpalosur në PFV.

Çështja 14 - Dobësi në menaxhimin e pasurisë - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Komisioni i inventarizimit kishte përfunduar inventarizimin, por nuk e kishte bërë krahasimin e gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare. Ky regjistër përmbante pasuri të zhvlerësuar e cila nuk ekzistonte fizikisht. Kjo është kërkesë e rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore.
- Rreziku** Mungesa e regjistrat të plotë dhe të saktë të pasurisë dhe mos krahasimi i regjistrat të pasurisë me gjendjen reale, vështirëson identifikimin e pasurive për të konfirmuar ekzistencën e tyre, si dhe rrit rrezikun që ato të keqpërdoren, humben apo tjetërsohen.
- Rekomandimi 14** Kryetari të siguroj që regjistrat e pasurive të jenë të plotë dhe të saktë, dhe për dobësitë e identifikuar gjatë inventarizimit të merren veprime konkrete për përmirësim në pajtim me kërkesat e rregullores për menaxhim të pasurisë.

3.2.2 Te arkëtueshmet

Vlera e llogarive të arkëtueshme në PFV për vitin 2016 është 1,801,000€. Struktura e llogarive të arkëtueshme përbëhet kryesisht nga: Tatimi në pronë, qiratë dhe taksat e aktivitetit të biznesit.

Çështja 15 - Nënvlërësimi i llogarive të arkëtueshme nga tatimi në pronë - Prioritet i lartë

- E gjetura** Komuna në PFV për vitin 2016 ka deklaruar llogaritë e arkëtueshme nga tatimi në pronë 1,182,000€, ndërsa sipas raportit të pranimeve dhe pagesave nga tatimi në pronë, vlera e të arkëtueshmeve është 1,197,690€, pra kemi një nënvlërësim prej 15,690€.
- Rreziku** Mungesa e shënimeve të sakta sa i përket llogarive të arkëtueshme, mund të sjellë gabime eventuale, dhe nëse këto nuk identifikohen me kohë, mund të shkaktojnë obligime shtesë për qytetarët, dhe rrjedhimisht me një pasqyrim jo të drejt të këtyre vlerave në PFV.
- Rekomandimi 15** Kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur kontrole të përmirësuara dhe më efektive, në mënyrë që evidentimi dhe pasqyrimi i saldoeve të llogarive të arkëtueshme të jetë i saktë.

Çështja 16 - Mungesa e kontratave valide për shfrytëzim të lokaleve afariste - Prioritet i lartë

- E gjetura** Tek kontrata për qiradhënie “Shfrytëzimi i lokalit afarist” ne kemi vërejtur se edhe këtë vit vazhdon shfrytëzimi i pronës komunale nga qiramarrësi, edhe pse i njëjti nuk ka përmbushur obligimet financiare ndaj komunës në vlerë 15,490€.
- Rreziku** Shfrytëzimi i pronave komunale në mungesë të kontratave valide, përveç që është në kundërshtim me ligjin, rrit rrezikun që këta shfrytëzues të refuzojnë obligimin financiar ndaj komunës dhe këto të hyra të mos inkasohen.
- Rekomandimi 16** Kryetari duhet të siguroj se çdo qiradhënie të ketë kontratë valide dhe realizimi i saj të mbikëqyret në vazhdimësi, si dhe të aplikohen masa ligjore në mënyrë që të maksimizohet niveli i inkasimit. Në të kundërtën, shfrytëzimi i pronave komunale duhet të ndërpritet.

3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2016 ishte 188,000€. Këto detyrime janë bartur për t’u paguar në vitin 2017.

Çështja 17 - Menaxhimi i dobët i faturave dhe vonesa në ekzekutimin e tyre - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Pranimit i faturave nga komuna bëhet nga drejtoritë përkatëse, e jo nga zyrtari i pranimit dhe si të tilla ato nuk protokollohen. Një veprim i tillë mund të ketë ndikuar në mangësitë e prezantuara më poshtë.
- Gjatë vitit 2016, janë paguar 304,289€, obligime të viteve paraprake, deri sa faturat e papaguara të prezantuara në fund të vitit 2015 ishin 293,064€. Bazuar në këtë komuna nuk ka prezantuar drejt obligimet për 11,225€.
- Në tetë (8) raste kemi vërejtur që pagesat e faturave nuk ishin ekzekutuar brenda 30 ditëve. Vonesat ishin nga 5 ditë deri 22 muaj, në një total prej 92,545€. Afatet për pagesë janë të parapara me rregullën financiare 01-2013 MF- Shpenzimi i parave publike.
- Rreziku** Mungesa e protokollimit me rastin e pranimit të faturave, rrit rrezikun e pagesës së dyfishtë, humbjes së faturave, si dhe vonesa në ekzekutimin e pagesave e rrit rrezikun e ekspozimit të komunës ndaj padive të mundshme, por edhe në dëmtimin e reputacionit të komunës.
- Rekomandimi 17** Kryetari duhet të forcoj kontrollet dhe të sigurojë se faturat protokollohen dhe Departamenti i financave do t’i evidentoj, kontrolloj dhe paguaj brenda afateve të përcaktuara ligjore të gjitha faturat e komunës.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Kryetari duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinionin të kualifikuar, opinionin të kundërt dhe mohimin të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
Pasqyrat Financiare	Kryetari duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PVF 2016 i adreson të gjitha çështjet e ngritura. Kjo, gjithashtu, duhet të përfshijë rishikimin e draft PVF-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime, në mënyrë që të njëjtat të mos përsëriten në vitet vijuese.		Ishin përmirësuar pagesat për donator të bazuar vetëm në memorandum të mirëkuptimit dhe keq klasifikimet por mbetet sfida raportimi i plotë dhe i rregullt i obligimeve dhe nënvlerësim i llogarive të arkëtueshme.	
	Kryetari duhet të sigurojë se ZKF raporton në mënyrë sistematike mbi progresin e IK-ve. Aty ku është e nevojshme, duhet të azhurnohen projektet në programin e IK-ve, në mënyrë që kërkesat e ardhshme buxhetore të jenë bërë në bazë të nevojave reale për investime.	E zbatuar.		

Qeverisja e mirë	Kryetari duhet të siguroj se janë bërë përpjekjet e nevojshme që punonjësit të paguhen sipas pozitave të planifikuara dhe vendimeve përkatëse të lëshuara. Më tej, të siguroj se komuna trajton të gjitha obligimet ligjore ndaj pretendentëve legjitim, në mënyrë që të mos të rezultoj deri të ekzekutimi i pagesave nga Thesari.		Janë bërë përpjekje në trajtimin e obligimeve ligjore ndaj pretendentëve legjitim por mbetet sfide rregullimi i koeficienteve të punonjësve në administratën komunale.	
Rekomandimet e vitit paraprak	Kryetari duhet të sigurojë që plani i veprimit, zbatohet, rishikohet dhe i njëjti përcakton saktë afatet kohore për implementimin e rekomandimeve të dhëna nga AP, me stafin përgjegjës të emëruar, për një monitorim rigoroz të këtij procesi. Sugjerojmë që edhe përfaqësues nga Kuvendi Komunal të jenë pjesë e këtij procesi.			Nuk monitorohet formalisht zbatimi i rekomandimeve. Disa nga rekomandimet kanë mbetur të pa zbatuara.
Qeverisja e mirë	Kryetari duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe në mënyrë proaktive të bëhet adresimi i fushave me dobësi të identifikuar. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar saktësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës për përgjigjet e konfirmuara. Një kontribut të mirë në konfirmimin e pohimeve të vetëvlerësimit mund ta jap Njësia e Auditimit të Brendshëm.		Lista kontrolluese e vetëvlerësimit është përgatitur por mbetet ende punë për ngritje të cilësisë.	
	Kryetari duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për regjistrin e menaxhimit të rrezikut tek një drejtor përkatës (apo ngjashëm) i cili në koordinim me udhëheqësit e njësive do të menaxhoj këtë proces dhe do të raportoj në baza të rregullta mbi rreziqet.			Nuk është zbatuar.

Auditimi i brendshëm	Kryetari duhet të sigurojë se sistemi i auditimit të brendshëm bëhet tërësisht funksional dhe përfitimet maksimale merren nga shërbimet e brendshme të sigurisë të ofruara nga AB. Nevoja për themelimin të Komitetit të Auditimit duhet të shqyrtohet.		Ishte themeluar komiteti i auditimit të brendshëm por mbetet të funksionalizohet në tërësi auditimi i brendshëm,	
Shpenzimet përmes prokurimit	Kryetari duhet të sigurojë se njësitë kërkuese vlerësojnë në mënyrë të drejtë kërkesat për prokurim. Zyra e prokurimit duhet të shtoj kujdes në përcaktimin e pozicioneve, dhe gabimet e tilla të mos përsëriten. Harmonizimet e kontratave për reflektim të ndryshimeve fiskale duhet të bëhen në mënyrë të rregullt si dhe pagesa e paguar më tepër ndaj OE duhet t'i kthehet buxhetit komunal. Të kërkohej përgjegjësi për pagesat e pozicioneve jashtë kontratës bazë. Gjithashtu, komisionet të përpilojnë raport për furnizimet e pranuar, para dërgesës së lëndës për certifikim.		Kishte përmirësime të dukshme tek prokurimi në shtimin e kujdesit dhe zvogëlimin e gabimeve në procesin për mbetet sfida për mbushjen e kontratave në përputhje me afatet e përcaktuara apo vonesa në realizimin e punimeve nga kontraktuesi të mundësohet aplikimi i penaleve për çdo ditë të vonuar zbatimit.	
	Kryetari duhet të analizoj me kujdes të gjitha rastet e përmendura më lartë dhe të vlerësoj arsyet për mangësitë e ndodhura në proceset e prokurimit. Të siguroj se kontrollet e certifikimit të pagesave dukshëm do të forcohen dhe do të parandalojnë të gjitha pagesat në mungesë të dokumentacionit përkatës.	E zbatuar		

Shpenzimet jo përmes prokurimit	Kryetari duhet të sigurojë se ndërmerren masa në mbikëqyrjen e marrëveshjeve me bashkëfinancim përfshirë kërkesat të qarta të raportimit gjatë implementimit dhe monitorimit të projektit, në pajtim me kërkesat e marrëveshjeve si dhe rregullave për shpenzimin e parasë publike. Tek rasti me Caritas, duhet të kërkohet llogaridhënie e plotë, në mënyrë që paratë e pa arsyeuara t'i kthehen buxhetit.		Ishte trajtuar rasti i catirasit dhe gjatë vitit 2016 nuk kishte arkëtuar mjete nga komuna për projekte por mbetet ende sfide mbikëqyrja e marrëveshjeve me bashkëfinancim sipas kërkesave për raportim dhe monitorim të projektit në përputhje me rregullat.	
	Kryetari duhet të sigurojë se kontrollet për shpenzimet operative vazhdojnë edhe në të ardhmen në mënyrë që të mos përsëriten shpenzimet joracionale sikurse ka ndodhur në vitin 2015. Më tej, për rastin e dytë duhet siguruar se shtohen veprime të theksueshme në shpenzimet e reprezentacionit, në mënyrë që drejtoritë të kuptojnë kërkesat dhe parimet e ekonomizimit të shpenzimeve.	E zbatuar.		
Pasuritë	Kryetari duhet të siguroj se do të miratohet një rregullore e brendshme e cila definon qartë kërkesat dhe përgjegjësitë për përdorimin e veturave. Personat përgjegjës për mbikëqyrjen e autoparkut duhet të sigurojnë se gjatë përdorimit të automjeteve zyrtare azhurnohen fletudhëtimet dhe veturat përdoren vetëm sipas aprovimeve të personave përkatës.		Kishte përmirësime te autoparku në mbikëqyrje por mbetet ende sfide miratimi i rregullores së brendshme.	

Paga dhe mëditje	Kryetari të siguroj që emërimet e kandidatëve bëhen vetëm pasi të jenë zbatuar të gjitha procedurat e rekrutimit dhe emërimit në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi.	E zbatuar.		
	Kryetari të siguroj se zyrtarët e pagesave i zbatojnë kërkesat e rregulloreve dhe verifikojnë fondin e orëve për kompensim të kujdestarive, sipas kërkesës për veprim lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë.		Është trajtuar pagesa e orëve për kompensim të kujdestarive por mbetet sfidë të zbatohet në tërësi rekomandimi.	
Subvencione dhe Transfere	Meqenëse organizimi i festivalit mbahet rregullisht çdo vit, ne rekomandojmë që Kryetari i Komunës këtë aktivitet ta inkorporoj në buxhetin vjetor në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve ndërsa organizimi i tij të bëhet përmes drejtorisë kompetente siç është paraparë me vendimin themelues. Të gjitha pagesat për financimin e festivalit duhet të kryhen përmes Llogarisë së Vetme të Thesarit dhe atë pas konfirmimit të rregullsisë së shpenzimeve nga ana e zyrtarit certifikues si dhe në kodin adekuat, mallra dhe shërbime. Përveç kësaj, procedurat e prokurimit duhet të zhvillohen në pajtim me ligjin dhe rregullat financiare.		Procedurat e prokurimit ishin zhvilluar për organizimin e festivalit por mbetet sfidë klasifikimi i shpenzimeve në kode ekonomike adekuate.	
	Kryetari duhet të sigurojë se subvencionimi bëhet vetëm në bazë të dëshmimeve adekuate e përcjellur kjo me plan detal dhe raporte kthyese relevante. Më tej, duhet të siguroj se Drejtoritë përkatëse mbikëqyrin dhe raportojnë në formë të detajuar narrative dhe financiare përcjellur me dëshmi të mjaftueshme dhe të besueshme mbi monitorimin e subvencionit. Procedurat e prokurimit të mos anashkalohen në asnjë rast ku ato mund të jenë të zbatueshme.	E zbatuar.		

Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë që drejtoritë e angazhuara në mbledhjen e të hyrave monitorojnë procesin e buxhetimit dhe performancën e aktiviteteve inkasuese. Qiradhëniet të mbështeten me bazë të fortë ligjore.		Kishte përmirësime në mbledhjen dhe monitorimin e të hyrave por mbeten sfida në marrëveshjet kontraktuale për të hyrat e qerasë së komunës.	
	Kryetari duhet të sigurojë se barazimet ndërdepartamentale duhet të kryhen në baza të rregullta mujore, derisa mjetet e mbledhura në arkë duhet të deponohen brenda ditës, në llogarinë komunale.		Barazimet ishin kryer por mbetet që mjetet e mbledhur në arkë të depozitohen brenda ditës në llogarinë e komunës.	
Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se procesi gjithëpërfshirës i regjistrimit të pasurive do të vazhdoj dhe brenda një afati optimal do të nxirret një regjistër përfundimtar mbi pasuritë e komunës. Zyrtari për menaxhim të pasurisë dhe zyrtarët e angazhuar në pranimin e mallrave/pasurive të komunikojnë në mënyrë efektive për të shmangur mos zbatimin e kërkesave të rregullores.		Ka progres në regjistrimin e pasurive si dhe në komunikim efektiv mes zyrtarëve për regjistrim të pasurisë por mbetet ende sfida për regjistrimin e plotë të të gjitha pasurive.	

Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë se bëhet një kontroll dhe vlerësim detal i vlefshmërisë së LL/A. Çdo qiradhënie të mbështetet me bazë të fortë kontraktuale dhe realizimi i saj të mbikëqyret në vazhdimësi dhe masa ligjore të aplikohen në mënyrë që të maksimizohet niveli i inkasimit. Vitin e ardhshëm, shpalosjet në pasqyra, t'i nënshtrohen një kontrolli rigoroz.	E zbatuar.		
Obligimet	Kryetari duhet të instaloj sistem të protokolimit të çdo fature të pranuar nga komuna dhe obligimet e sakta të raportohen në MF në baza mujore.		Ishin raportuar në baza mujore obligimet por mbetet të zbatohet protokollimi i faturave.	
	Kryetari duhet të sigurojë se ZKF dhe Zyra ligjore bën një vlerësim të përafërt të detyrimeve kontingjente në mënyrë që shpalosjet në PVF të jenë përafërsisht të sakta. Për të shmangur kontestet gjyqësore, aktivitetet, vendimet si dhe kontratat duhet të jenë legjitime dhe të menaxhohen në mënyrën e duhur. Kërkesat gjyqësore, të futen në projeksione buxhetore të kategorive përkatëse.		Ishin trajtuar detyrimet kontingjente por mbetet sfide zbatimi në tërësi i rekomandimit.	

Shtojca IV: Letërkonfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-kline.org

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



LETËR E KONFIRMIMIT

REPUBLIKA E KOSOVËS | REPUBLIC OF KOSOVO | REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA KLINË
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA
01 Nr.No.Br. 401-3241/17
Data-Data-Datum 02.06.2017
Klinë-Klina

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vendi dhe data: Klinë, 02. 06. 2017

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Klinës, për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Kryetari:

Sokol Bashota

